



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P.573/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sulollari” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-68302-05-10-2018 me objekt: “Mirembajtje Impiantistike”, me fond limit 2.599.920 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni” Tiranë

Ankimues:

Operatori ekonomik “Sulollari” sh.p.k
Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha” 71/3 kati 1 Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Glozheni”
Adresa: Bulevardi “Bajram Curri” Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 11.05.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-68302-05-10-2018, me objekt : “Mirembajtje Implantistike”, me fond limit 2.599.920 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 12.06.2018 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni” Tiranë.

II.2. Në datën 12.06.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi në këtë procedurë prokurimi rezulton se në datën 16.07.2018 (shkresë nr. 1014prot datë 13.06.2018) autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues “Sulollari” sh.p.k. të bëjë argumentimin ekonomik të ofertës së paraqitur në lidhje me ofertën anomalisht të ulët, në bazë të nenit 56 të ligjit ”Për prokurimin publik” i ndryshuar .

II.3.1. Në datën 18.06.2018 operatori ekonomik Sulollari” sh.p.k. me shkresën nr. 1039 datë 18.06.2017, (referuar proces -verbalit të mbajtur nga autoriteti kontraktor) paraqiti “Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 1014 prot. Datë 13.06.2018 (Shpjegim për ofertën anomalisht të ulët)”, sqarime të

cilat pasi u shqyrtuan nga KVO-ja e autoritetit kontraktor, u vlerësuan se nuk janë të plota, sepse nuk është bërë analizë kostoje sipas objektit të tenderit që është “Mirëmbajtje Impjanistikë”.

II.3.2. Në datën 18.06.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Referuar raportit të auditimit të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | | | | |
|------|---------------------|--------------|------|---------------|
| i. | “Sulollari” shpk | 1,836,000 | lekë | skualifikuar; |
| ii. | “Super Klima ” shpk | 1,949,940 | lekë | skualifikuar; |
| iii. | “Climacasa” shpk | 1,950,199.60 | lekë | skualifikuar; |

II.3.3. Operatori ekonomik “Sulollari” sh.p.k. është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit si më poshtë vijon: “[...]”

është ofertë anomalisht e ulët. Në shkresën shpjeguese të paraqitur, nuk ka bërë analizë kostoje për çdo zë të preventivit ku të shpjegohen orët e punës së puntorit, paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ,çmimi për materialet ,shpenzimet e tjera.

II.4. Në datën 20.06.2018 operatori ekonomik “Sulollari” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Autoritetit Kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

[...]Në datën 12.06.2008 ora 10:00 mori pjesë në procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm. Në datën 16.06.2018 u njoftuam me rrugë postare nga AK-ja se oferta jonë rezulton anomalisht e ulë dhe kërkohet nga ana jonë argumenti ekonomik i ofertës së paraqitur. Në datën 18.06.2018 u paraqitëm pranë autoritetit kontraktor justifikimin ekonomik të ofertës së ofertës tonë. Në datë 18.06.2018 jemi njohur me vlerësimin e autoritetit kontraktor nga ku rezultoi se oferta jonë ishte skualifikuar me arsyen e poshtëshënuar: Oferta është anomalisht e ulët. Në shkresën shpjeguese të paraqitur, nuk ka bërë analizë kostoje për çdo zë të preventivit ku të shpjegohen orët e punës së puntorit, paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ,çmimi për materialet ,shpenzimet e tjera.

Së pari në tender ishin pjesëmarrës dhe dy firma të tjera përveç firmës tonë të cilat ishin skualifikuar për arsye të cilat ne nuk jemi vëmë në dijeni si firma pjesëmarrëse. Kjo më tepër për të bërë përrlllogaritjen e ofertës anomalisht të ulët që do të thotë janë skualifikuar për mungesë dokumentacioni të dyja firmat e tjera apo dhe ato për mospranim justifikimi nga ana juaj të ofertës anomalishtetë ulët. Së dyti vlerësimi i AK-së është totalisht i gabuar dhe në kundërshtim të plotë me LPP-në . Shoqëria jonë nuk është dakord me vlerësimin dhe skualifikimin e saj nga kjo procedurë prokurimi, e në këto kushte bazuar në nenin 63 pika 2 e LPP-së i ndryshuar po ju paraqesim ankesën tonëduke argumentuar si më poshtë:

Duke u bazuar tek nenet:

Referojmë nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”[...]

Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dst. Nuk duhet të përdorë asnjë kriter që nuk

është përfshirë në dokumentat e tenderit. Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm mbi baza teknike dhe ekonomike.

Autoriteti kontraktor përcakton ofertën më të mirë pas krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Referojmë nenin 56 të LPP-së[...],

Pra siç shihet dhe nga nenet e lartpërmendura AK-ja kërkon shpjegime element të veçantë të ofertës. Ku në rastin konkret është kërkuar vetëm ana ekonomike. Dhe ku ne kemi sqaruar dhe shpjeguar me shumë hollësi dhe detaje shumë prej zërave të preventivit dhe vlera në lekë ishte më e lartë dhe ku zërat ishin furnizim/vendosje . bashkëlidhur justifikimit tonë ju kemi dërguar edhe fatura blerje malli. Kemi dorëzuar mjaft fatura blerjeje malli ku shihet qartë cmimi i blerjes dhe diferenca blerje-shitje të mallit të këkuar dhe ofertuar. Tek neni 56 i LPP-së nuk përcaktohet që ofertuesi duhet të analizojë çdo zë të preventivit apo 100% ofertën, por kërkohet një argumentim ekonomik i metodës së ndërtimit të ofertës së paraqitur, të cilën ne mendojmë që kemi dhënë shumë sqarime. Përsa i përket pretendimit tuaj në lidhje me orët e punës dhe pagat e punëtorëve po ju bëjmë me dije se ju keni kërkuar dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore të cilat ne i kemi dorëzuar në procedurën e tenderimit ku çdo gjë shihet qartë dhe ndoj që kjo pikë është e sqaruar. Gjithashtu ne përveç anës ekonomike ne jemi munduar të sqarojmë dhe zgjidhjet teknike të ofruara për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo shërbimeve dhe zbatueshmërinë e detyrimeve. Gjithashtu ju duhet të merrni parasysh dhe eksperiencën tonë në këtë fushë duke u bazuar dhe në kontratat e ngjashme dhe vërtetimet e realizimit të tyre që ne kemi dorëzuar gjithashtu dhe në punën e kryer nga firma jonë më përpara me institucionin tuaj. Së treti shoqëria jonë ka dhënë ofertën më të ulët për këtë procedurë prokurimi dhe konkretisht fondi limit 2,599,920 lekë ka ofertuar në vlerën 1836000 lekë duke i kursyer buxhetit të shtetit një vlerë prej X lekë. Referojmë nenin 1 dhe 2 të LPP-së [...] Referuar vlerësimit të AK-së rezultoi se ky parim i LPP-së është shkelur duke na skualifikuar pa të drejtë.

Si përfundim bazuar në arsyetimin dhe në argumentat e parashtruara s më sipër shoqëria jonë kërkon rivlerësimin e kësaj prceure prokurimi duke kualifikuar dhe shpallur fitues shoqërinë tonë[..]

II.5. Autoriteti Kontraktor me shkresën me anë të shkresës Nr. 1063 Prot. datë 21.06.2018., i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Sulollari” sh.p.k në lidhje me pretendimet e ngritura prej tij duke mos e pranuar ankesën e tij.

II.6. Në datën 29.06.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e depozituar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1214/1 prot., datë 25.07.2018, protokolluar me tonën me nr. 1201/3 datë 09.08.2018 me objekt “Kthim përgjigje”, si dhe shkresës nr. 1265prot datë 10.08.2018, protokolluar me tonën nr. 1201/4 prot., datë 10.08.2018 me objekt “Shtesë Informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Sulollari” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se: *është ofertë anomalisht e ulët. Në shkresën shpjeguese të paraqitur, nuk ka bërë analizë kostoje për çdo zë të preventivit ku të shpjegohen orët e punës së puntorit, paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, çmimi për materialet, shpenzimet e tjera.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...]”.

Public Health Sector

III.1.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.3. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e

ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për të dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjen teknike zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezultojnë anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangijen e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezultojnë anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezultojnë anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezultojnë anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.*

III.1.4. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se oferta në vlerën 1,836,000 lekë pa përfshirë vlerën e Tatimit Mbi Vlerën e Shtuar, në respekt të nenit 66 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, rezultojnë anomalisht e ulët, ndaj, autoriteti kontraktor ka vepruar drejt ku në zbatim të parashikimeve të *lex specialis*, neni 56 dhe neni 66 të VKM 914/2014 i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik ankimues mbi ofertën e dorëzuar në këtë procedurë prokurimi.

III.1.5. Referuar parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se në datën 16.06.2018 autoriteti kontraktor ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik “Sulollari” sh.p.k, mbi ofertën ekonomike e cila rezulton anomalisht e ulët në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Në përgjigje të kërkesës së këtij të fundit, operatori ekonomik ankimues në datën 18.06.2018 (shkesa datë 18.06.2018 protokolluar në autoritetin kontraktor me nr. 1014prot.) ka parashtruar pranë autoritetit kontraktor argumenta mbi ofertën e dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, e konstatuar si anomalisht e ulët nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik bashkëlidhur ankesës rezulton se nga ana e këtij të fundit, me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- shkresën datë 18.05.2017, paraqiti “Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 1014 prot. Datë 13.06.2018 (Shpjegim për ofertën anomalisht të ulët)”,
- Faturë tatimore shitjeje nr. 308 datë 28.04.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; Gaz Freon; Nastr; tub bakri; amoflex 1/4; amoflex1/2)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 201 datë 30.11.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; Gaz freon; tub bakri12m)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 172 datë 28.05.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; DXR)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 43 datë 14.02.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; Pult; paketë)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 91 datë 31.03.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; QXR24 Btu; UO3;U10;Rkondes 60MF; stc9200; amoflex f6; amoflex f10; amoflex f22)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 92 datë 31.03.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; R134Drip; SKF 6204; SKF6203; Rakondes 35 mf; rakondes 40mf; rakordes 45MF 3dalje; rakorses 60MF 3dalje; rakordes 50MF 3 dalje;)
- Faturë shitjeje nr. 405147 datë 01.06.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit:lëshues [..];)
- Faturë shitjeje nr. 8 datë 30.04.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit:Rek termike;
- Faturë tatimore shitjeje nr. 37 datë 27.01.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; thurje motor ventilatori;)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 123 datë 23.02.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; saracineskë;)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 15 datë 20.03.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; thurje element i pompës Gruneos;)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 823 datë 18.01.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; vana radioatori SDR 102KEND FM; Radiatorë 22 600x800;)
- Faturë tatimore shitjeje nr.949 datë 02.05.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; regulator pres uji 1/2;)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 61 datë 30.01.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; rekorderi;)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 293 datë 24.04.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; tuba plastike;)

- *Faturë tatimore shitjeje nr. 99 datë 09.11.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; Tubo 12;tubo 16)*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 2953 datë 12.05.2018 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; prof celiku[.]);)*
- *Faturë tatimore shitjeje nr.461 datë 01.07.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit;;)*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 6651 datë 03.11.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; filter thes;)*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 6718 datë 17.11.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; radiator; filter bakterologjik 99%;)*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 366 datë 14.12.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; pompë enë zgjer 19 litra;)*
- *Faturë tatimore nr. 01 datë 17.03.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; tub; xhuto; brryl; tub; manik 140 l;)*
- *Faturë tatimore nr. 32 datë 19.03.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; stufon; upa 10; bullon dado; thika[.])*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 857 datë 23.012.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; lesh xhami;)*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 37140903 datë 13.06.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; tubo bakri; paketë elektronike; mot kond;)*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 393 datë 27.06.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; tuba; dupan;)*
- *Faturë tatimore shitjeje nr. 992162 datë 07.04.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; contenitorë; celës i thjeshtë; automat; kabëll fleks;)*
- *Faturë tatimore nr.25 datë 13.06.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; materiale elektrike;materiale hidraulike)*
- *Invoice nr. 20161124/V.T. 609R1*

III.1.7. Gjithashtu, krahas dorëzimit të dokumentacionit provues (fatura/vërtetime etj) ankimuesi ka dorëzuar njëherazi edhe një përshkrim analitik të metodës së hartimit të ofertës ekonomike, ku ndër të tjera ka argumentuar se vlera e ofertës ekonomike (referuar çmimit për njësi) është e mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve të kontratës dhe se kjo e fundit është hartuar referuar çmimeve të faturave tatimore të shitjes, të cilat operatori ekonomik i ka sjellë për të mbështetur ofertën e tij ekonomike.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar para autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP gjykon se nga ana e ankimuesit në përmbushje të parashikimeve të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, janë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor përshkrime narrative si edhe dokumentacion shoqërues dhe provues mbi argumentimin ligjor, teknik dhe ekonomik të ofertës së dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 gërma “a” të ligjit nr.9643/2006 në drejtim të argumentimit të *anës ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara*, si një prej 4 kushteve kumulative, ankimuesi ka dorëzuar një përshkrim të kostos për njësi të zërave të preventivit të ofruar në të cilën ka përshkruar kostot e materialeve si dhe kostot ekstra si shpenzime për stafin, makineritë dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e objektit të kontratës së prokurimit.

Në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643/2006 në drejtim të argumentimit të zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; si një prej 4 kushteve kumulative, ankimusi ka dorëzuar fatura tatimore të blerjes së mallrave të nevojshme për furnizimin dhe vendosjen e tyre sipas objektit të prokurimit në të cilën deklarohen çmime për njësi, të cilat parë me sasinë e kërkuar për kryerjen shërbimit objekt prokurimi çmimi për sasi sipas listës së përbërësve të deklaruar nga ana e ankimuesit janë me një çmim më të ulët nga cmimi i mallrave të ofruar në ofertën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor si një prej 4 kushteve kumulative. Akoma më tej, KPP konstaton se ankimuesi njëherazi ka provuar para autoritetit kontraktor eskperiencën e tij të ngjashme në lidhje me furnizimin, vendosjen dhe përmbushjen me sukses të kontratave për furnizimin me mallra objekt prokurimi me autoritete të tjera kontraktore. Gjithashtu, ankimuesi në përlllogaritjen e kostos së ofertës ekonomike të dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, në analizën teknike (metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës), mbi njësinë e kërkuar ka përlllogaritur edhe shpenzimet mbi punëtorinë, shpenzieme të cilat janë mbi kufirin minimal të lejuar nga ligji.. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar ankimues përmbush katër kushtet kumulative të kërkuar nga ligji i posaçëm në drejtim të argumentimit të ofertës ekonomike anomalisht të ulët. Komisioni i Prokurimit Publik pasi analizoi informacionin e dërguar, vëren se përveç faturave tatimore të shitjeve, operatori ekonomik ankimues ka bashkëlidhur edhe një informacion të detajuar lidhur me analizimin e kostos për zërat/elementët e veçantë të ofertës së paraqitur (që lidhen konkretisht me rele termike, lëshues 25A për chillera, paketë elektronike kondicioneri, filtra të ndryshme apo shpenzime të tjera), duke krijuar në këtë mënyrë bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Paraqitja e faturave tatimore të shitjes të shoqëruara me analizën e kostos për të gjithë zërat element të preventivit mund të konsiderohen si prova bindëse për realizimin me sukses të kontratës.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka rezultuar anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Është detyrim i operatorëve ekonomikë që në rast të shpalljes fitues t’i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtin cilësi të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sulollari” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-68302-05-10-2018, me objekt : “Mirembajtje Impiantistike”, me fond limit 2.599.920 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 12.06.2018 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koco Gliozheni” Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Sulollari” sh.p.k. duke e kualifikuar atë nga procedura e prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Sulollari” sh.p.k.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1201 Protokoli; Datë 29.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha